



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E FINANCAVE

MINISTRI

Nr. 10468/1 Prot.

Tiranë, më 22.7.2014

URDHËR

Nr. 4..., Datë 22.7.2014

PËR

SHPALLJEN E STANDARDEVE KOMBËTARE TË KONTABILITETIT TË PËRMIRËSUARA DHE ZBATIMIN E DETYRUESHËM TË TYRE

Në mbështetje të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", të ndryshuar, të vendimit nr. 1, datë 25.06.2014 të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit "Për miratimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara":

URDHËROJ :

1. Shpalljen e 14 Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, sipas materialeve përkatëse bashkëngjitur.
2. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara bëhen të detyrueshme për zbatim në datën 1 Janar 2015.
3. Deri në datën e zbatimit, me përdoruesit e tyre të organizohen seminare dhe trajnime në nivel kombëtar dhe lokal.
4. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara të publikohen në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Financave.
5. Shpallja e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara hyn në fuqi me botimin e tyre në Fletoren Zyrtare.

